



Raport vjetor 2023

QENDRA RINORE ARDHMËRIA–KLINË

KOSOVË

1 Janar & 31 Dhjetor 2023

PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI

ME 31/12/2023

KLINË



Hyrje:

Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit janë zhvilluar programet dhe iniciativat rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara në Qender Rinore Ardhmëria-Klinë gjatë vitit kalendarik 2023.

Aktivitetet e qendrës rinore Ardhmëria-Klinë të cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:

1. AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE

2. BASHKËPUNIMET & PARTNERITET

3. PROJEKTET

4. STATISTIKAT /PËRFITUESIT

1. KURSET-AKTIVITETE TE PËRDITSHME

Kursi I gjuhës Angleze, është zhvilluar me një grup të femijeve të moshës 7-10 vjeç, ky kurs është zhvilluar nga Vullnetari i Korpusit të Paqes Amerikan dhe ka zgjatur 6 muaj.



2. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE

2.1 DITA E PAVARSISË SË KOSOVES

Rrnofsh o vendi im i lir, vendi Im ku e kam paqen dhe qetësin, ku e kam gëzimin e haren, ku e kam mësimin edhe lojen, ku e kam lotin edhe bojen...prandaj me bojera vullnetarët nisen dhe përfunduan murales në hyrje të Qendres Rinore për të shënuar festën e Pavarësisë.

Javë e mbushur me aktivitete për vullnetarët tonë të cilët me shumë emocione, këngë, poezi përfunduan aktivitetin e murales për të vazhduar tutje me aktivitete të radhes.

RRNOFSH VENDI IM!

Zhvilluar me 17 Shkurt 2023



2.2 DITA BOTERORE E UJIT

Dita botërore e Ujit shënohet për çdo vit më 22 mars. Kjo ditë është përcaktuar me rezolutën e OKB në dhjetor të vitit 1992.

Me shënimin e kësaj dite Qendra Rinore dhe vullnetaret kanë për qëllim të rrisin vetëdijen për rëndësinë e mbrojtjes së ujërave dhe mungesën e ujit të pijshëm në qytetin e Klinës. Sot kemi zhvilluar një ligjeratë edukative për fëmijët e moshës 12-14 vjeç. Falenderojm vullnetaret për punën vullnetare në edukimin jo- formal.

Zhvilluar me 22 Mars 2023



2.
3
DI
TA
B
OT
ËR
O
RE

E SHËRBIMIT RINOR NË KOMUNITET

Të rinjtë nga Klina mbollën 100 lule në parkun "Irir Merturi" në Klinë. Aktiviteti kishte për qëllim edukimin e të rinjve për mjedisin natyror dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për mbrojtjen e mjedisit. Grupi i të rinjve u kënaq duke mbjellë lule me të rinjtë dhe fëmijët e vegjël që i'u bashkuan aktivitetit. Aktiviteti u mbështet nga vullnetarët dhe fëmijët.



2.4 DITA BOTËRORE E LUFTES KUNDER DUHANIT

Vullnetarët e organizates janë angazhuar dhe kanë organizuar Fushatë-Ligjeratë edukative kunder duhanit. Duhani si dukuri negative shumë e pranishme tek të rinjtë, dhe gjëgjësisht tek moshë shumë e re. Aktiviteti ynë kishte për qëllim që të ngrisin vetëdijen për pasojat që shkakton duhani si dukuri negative.

Në këtë ligjeratë moren pjesë 27 të rinjë e moshës 12-14 vjeç, nxënës të shkolles " ismet Raci" në Klinë.

Zhvilluar me 31 Maj 2023



2.5 DITA E FEMIJEVE-1 QERSHORI

Dita e Fëmijëve shënohet me 1 qershor në mbarë botën. Fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë, që në këtë ditë të ndihen të lumtur dhe të festojnë me prindërit dhe bashkëmoshatarët e tyre. Edhe në qytetin tonë të Klinës Vullnetarët e Qendres Rinore Ardhmëria shënuan ditën e 1 Qershorit me shumë lojëra kreative për fëmijë në parkun e qytetit "Ilir Merturi".

Me 1 Qershor fëmijët kanë ditën e tyre të festës, dhe të rinjtë zhvilluan aktivitetet e larmishme për ta bërë këtë ditë sa më të bukur për të vegjlit. Në këtë aktivitet moren pjesë një numër i madh fëmijësh, ku shihej një gezim dhe një buzëqeshje në fytyrat e secilit fëmijë. Ky aktivitet është realizuar në bashkëpunim me mësuesen Resmije Berisha (sh.f. Motrat Qiriazzi) dhe nxënësit e saj, falenderojm shumë mësuesen për pjesëmarrje në aktivitetet tona si dhe të gjithë prindërit e fëmijëve.



Zhvilluar me 1 Qershor 2023

2.6 SEMINAR EVROPIAN

Më 24 maj, 5 të rinjë nga Klina dhe 15 të rinjë nga 5 vende të ndryshme evropiane iu bashkuan PaLS projektit për të bërë një shërbim vullnetar në të ashtuquajturat "Ekipe të Korpusit të Solidaritetit Evropian" në periudhë dy javore. Detyra e tyre: të ndërtojnë një shteg natyror Permakulturor dhe të njihen me njëri-tjetrin.

Një nga pjesëmarrësit, Prek Simonaj, do të vazhdojë të punojë në Parkun e Permakulturës për një periudhë 12-mujore, ndërsa edhe Edisona Franca nga Drenasi punon nga tetori 2022. Edisona është në muajin e fundit duke përfunduar Projektin e saj ESC në Steyerberg.



Zhvilluar me 07 Qershor 2023



2.7 FUSHATË VETËDIJËSUESE

Se Bashku kundër dukurive negative në Kosovë.

Sot, në kuader të projektit: Empowering links between CSOs and public Institutions in promoting the Rule of Law in Kosovo” në bashkëpunim me organizatën 'Human Kosova të rinjtë kanë shpërndarë 200 fletushka vetëdijësuese kunder dukurive negative.

Zhvilluar me 06 Qershor 2023.



2.8 TAKIMI I ANTARËVE TË THEMELIT TË ORGANIZATES Pikërisht në ditën

ndërkombëtare të rinisë' pas shumë viteve punë patëm mundësi të realizojm një takim me themeluesit e Qendres Rinore, ky ishte stafi i parë i qendres që punuan aq shumë që rinia e sotshme t'i gezojn këto mundësi të aktiviteteve rinore dhe ta vazhdoi misionin e organizates që ky grup themeloi në vitin 1999.



Zhvilluar me 13 Gusht 2023

2.9 VIZITA E PRESIDENCES SE KOSOVES

Me 18 Gusht, patëm kënaqësi të na vizitoj presidentja e Kosovës znj.Vjosa Osmani. Stafi dhe të rinjtë vullnetar nga **Qendra Rinore Ardhmëria Klinë** për me shumë se 20 vite punë dhe programe rinore, në historinë e organizatës për herë të parë vizitohemi nga Presidenca e Kosovës.

Të rinjtë vullnetar me shumë kënaqësi prezantuan dhe diskutuan për punën dhe sakrificat që rinia e Klinës ballafaqohet çdo ditë pasi që nuk kemi objekt për qendër të rinisë në Klinë, gjithashtu treguan për energjinë dhe motiviminë rinisë për të punuar si vullnetar të **Qendra Rinore Ardhmëria Klinë**.



Realizuar me 18 Gusht 2023



2.10 JAVA E RINISË NË KLINË

Java e rinisë është organizuar nga DKRS dhe ne si Qender Rinore ishim bashkëpunor të kesaj jave të rinisë, Dita jonë ishte Piktura në natyrë dhe arritem me pikturim në qytet me nxënës të shkollave dhe të rinjtë nga [QENDRA RINORE ARDHMËRIA KLINË](#), gjithashtu me kënaqësi sot kemi pritur mysafirë nga Qendra Rinore [SHL-KOSOVA](#) - Komuna e Rahovecit të cilët u bënë pjesë e aktivitetëve tona. Një ditë e kaluar kaq mirë! Faleminderit gjithë bashkëpunorëve!



Zhvilluar me 5

Tetor 2023.

2.11 NGJARJE HALLOWEEN

Aktiviteti i Halloween 🎃, Qendra Rinore, 31 Tetor 2023,

Më 31 tetor Qendra Rinore në partneritet me mësuesen e shkollës Fillore "Motrat Qiriaz" organizuam një festë për Fëmijë dhe të rinjë. Gjatë aktivitetit vullnetarët nga qendra rinore punuan me 30 fëmijë. Ata krijuan dhe drejtuan aktivitete duke filluar nga vizatimi i fytyrës, puntori edukative, Lojra shpërblyese dhe vallëzim. Fëmijët u kënaqën gjatë aktivitetit për dy orë dhe në fund reflektuan mbi ecurin e aktivitetit ku fëmijët patën mundësi të shprehin kënaqësitë dhe pakënaqësitë e këtij eventi. Më pas, vullnetarët reflektuan se çfarë shkoi mirë dhe çfarë do të bënin ndryshe për aktivitetin vitin e ardhshëm.

- Urime festa Halloween 🎃



2.12 SESIONI PARË

Me 3 Nëntor 2023 filluam me “Kurs trajnimit – Të rinjtë avokojnë për veten e tyre kundër dhunës në familje. Sot, është realizuar Sesioni parë dhe moren pjesë një grup I të rinjve të cilët do të jenë aktiv gjatë tërë programit 8-të javor në Klinë. Kursi organizohet në kuader të projektit ”Të rinjtë në parandalimin e dhunës në familje” i përkrahur nga “Fondacioni i të rinjve Evropian të Këshillit të Evropes, si dhe i implementohet nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë.



2.13 SESIONI I DYTË

Me 10 Nëntor 2023 zhvilluam session e dytë të “Kurs trajnimit – Të rinjtë avokojnë për veten e tyre kundër dhunës në familje. Sessioni I dytë është fokusuar në ndertimin e vetëbesimit ku të rinjtë mësuuan se si duhet të vlerësojnë veten e tyre, të njohin identitetin personal, dhe të praktikojnë vetit e shëndetshme gjatë tërë jetës së tyre.

Kursi organizohet në kuader të projektit ”Të rinjtë në parandalimin e dhunës në familje” i përkrahur nga “Fondacioni i të rinjve Evropian të Këshillit të Evropes, si dhe i implementohet nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë.



2.14 SESIONI I TRETË

Me 17 Nëntor 2023 zhvilluam sessione e tretë të “Kurs trajnimit – Të rinjtë avokojnë për veten e tyre kundër dhunës në familje. Sessioni i tretë është fokusuar në temën “Siguria” Ne, të rinjtë mund të luajmë rol në sigurinë tonë, si ndertohe siguria? dhe sa e rëndësishme është për neve dhe shoqërinë tonë. Kursi organizohet në kuader të projektit “Të rinjtë në parandalimin e dhunës në familje” i përkrahur nga “Fondacioni i të rinjve Evropian të Këshillit të Evropës, si dhe i implementohet nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë



2.15 SESIONI I KATERTË

Me 24 Nëntor 2023 zhvilluam sessione e 4të “Kurs trajnimit – Të rinjtë avokojnë për veten e tyre kundër dhunës në familje. Sessioni i 4të është fokusuar në temën “Faktorët shoqëror prijës për dhunë në familje” të rinjtë mësuam se cilët janë shkaktarët shtytes dhe terheqës që i bëjnë njëzërit të pafuqishëm ndaj dinamikave të dhunës familjare. Kursi organizohet në kuader të projektit “Të rinjtë në parandalimin e dhunës në familje” i përkrahur nga “Fondacioni i të rinjve Evropian të Këshillit të Evropës, si dhe i implementohet nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë.



2.16 FESTA E 28 NËNTORI

Event kulturor dedikuar festes së 28 Nëntorit. Të rinjtë vullnetar organizuan programin festiv për festën e flamurit kombëtar. Programi ishte i karakterit garues në mes të nxënësve të dy shkollave fillore të qytetit, performuan Valle, Poezi dhe Shfaqje teatrale.

-Poezia fituese, Jona Behramaj nga Sh.F.M.U "Ismet Raci"-Klinë.

-Vallja fituese, valle tropojane e grupit të të rinjve nga shkolla Sh.F.M.U "Ismet Raci"-Klinë

-Shfaqje teatrale fituese "Princesha pikëlluar" nga Sh.F.M.U " Motrat Qiriazhi"-Klinë.

Fituesit janë shpërblyer me dhurata simbolike ndërsa për të gjithë pjesëmarrësit në këtë Event festiv janë shpërblyer me nga një mirënjohje.

Eventi kulturor është organizuar në kuader të projektit "Nisma për fuqizimin e rinisë" nga [Qendra Rinore Ardhmeria Klinë](#) në bashkëpunim me Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dy shkollat fillore "Ismet Rraci" dhe "Motrat Qiriazhi", projekti është i mbështetur nga MKRS-Prishtinë.

URIME 28 NËNTORI



2.17 SESIONI I PESTË

Me 1 Dhjetor 2023 zhvilluam session e 5të "Kurs trajnimit – Të rinjtë avokojnë për veten e tyre kundër dhunës në familje. Sessioni i 5të është fokusuar në temën "Zhvillimi I aftësive të komunikimit" të rinjtë mësuam se cilët janë aftësitë e të dëgjuarit dhe të kuptuarit e empatisë, dhe si të rinjtë mund të përdorin aftësitë e komunikimit në rast të dhunës në familje apo në shoqëri. Gjithashtu në këtë session janë diskutuar disa tema që ende janë Tabu dhe të rinjtë nuk mund ti shprehin me familje dhe shume pak diskutohen edhe në shoqëri.

Kursi organizohet në kuader të projektit "Të rinjtë në parandalimin e dhunës në familje" i përkrahur nga "Fondacioni i të rinjve Evropian të Këshillit të Evropës, si dhe i implementohet nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë.



2.18 SESIONI I GJASHTË

Me 08 Dhjetor 2023 zhvilluam session e 6të "Kurs trajnimit – Të rinjtë avokojnë për veten e tyre kundër dhunës në familje. Sessioni i 6të është fokusuar në temën "T'i kuptojmë më lehtë rolet dhe normat gjinore" të rinjtë mësuuan për normat gjinore dhe menyrën me të lehtë për të krijuar një mirëkuptim me prinderit, si dhe përfshirja e prindërve në aktivitete të përditshme të cilat do të ndikojnë pozitivisht tek bashkimi familjar. Kursi organizohet në kuader të projektit "Të rinjtë në parandalimin e dhunës në familje" i përkrahur nga "Fondacioni i të rinjve Evropian të Këshillit të Evropës, si dhe i implementohet nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë.



2.19 SESIONI I SHTATË

Me 15 Dhjetor 2023 zhvilluam session e 7të "Kurs trajnimit – Të rinjtë avokojnë për veten e tyre kundër dhunës në familje. Sessioni i 7të është fokusuar në temën "Si mund t'i përfshijmë të rinjtë më shumë në fushatë kundër dhunës në familje". Të rinjtë mësuuan se si të udhëheqin një fushatë në rrjetet sociale që synon mbrojtjen e të rinjve në raste të dhunës në familje dhe shoqëri. Kursi organizohet në kuader të projektit "Të rinjtë në parandalimin e dhunës në familje"



i përkrahur nga "Fondacioni Evropian Rinisë të Këshillit të Evropës, si dhe i implementohet nga [Qendra Rinore Ardhmeria Klinë](#)

1.20 INICIATIVA HUMANITARE 🌲

Shitja e kartolinave _Të rinjtë nga Qendra Rinore Ardhmeria Klinë ne menyre vullentare kane punuar kartolina kreative gjate dy javeve dhe ato kartolina jane shitur per Krishtlindje gjate tere javës në qendër të qytetit.



Shitja e embëlsirave_ Në qendër të Klinës, embëlsirat janë gatuar nga vet të rinjtë të cilet me këto fonde të mbledhura do të ndihmojnë disa familje.



SHPERNDARJA E NDIHMAVE

Puna vullnetare në Qendrën Rinore Ardhmeria solli një punë intensive të të gjithë vullnetarëve aktiv gjatë muajit Dhjetor 2023, në përgatitjen dhe dekorimin e kartolinave dhe për urime festive të Krishtlindjes dhe Vitit të Ri. Pas përgatitjes së kartolinave vullnetarët u angazhuan në përgaditjen e pakove humanitare në sheshin kryesor të Klinës për shitjen e këtyre materialeve si kartolina dhe embëlsira... fondet e të cilave ishin të destinuara për blerjen e pakove për familje. Fondit për bamirësi ju kanë bashkangjitur edhe bizneset private të Qytetit të Klinës dhe ishin te gatshem japin kontributin e tyre për familjët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Kështu u siguroi një fond simbolik i cili u shpenzua për blerjen e artikujve dhe mbushjen e pakove me dhurata për 7 familje. Andaj, si përfundim, me 21 Dhjetor, vullnetarët e vet organizuar dhe të mbështetur nga "Qendra Rinore Ardhmeria shkuan derë me derë për tu uruar familjeve në

nevojë festat e fund vitit me nga dy pako dhuratë me gjëra ushqimore dhe higjienike të cilat u dhuruan nga vet të rinjtë.

Përmës kësaj Iniciative humanitare "Qendra Rinore Ardhmeria" u angazhua të përgatis të rinjë me vlera humane dhe ngritje të ndjenjes për punë vullnetare për tu shërbyer të tjerëve në nevojë.

Falenderojm të gjithë qytetarët dhe bizneset që kontribuan në këtë Iniciativë, si dhe bashkëpunorët tonë komunal si: Drejtorinë për Rini, Kulturë dhe Sport, dhe Drejtorinë për Shërbime publike dhe në veqanti ekpin e zjarrfikësve që mundësuan transportin e pakove humanitare.



Zhvilluar me 12 Dhjetor'23



1.22 PERMBYLLJA E VITIT 2023

Qendra Rinore Ardhmeria Klinë përmbyll vitin 2023 me shumë aktivitete të ndryshme, përmbyllja e vitit 2023 është festuar me një mbrëmje festive për 🎄🎁 Krishtlindje dhe Vitin e ri 🎄.

Të rinjtë 🎉 festuan me lojra dhe muzik argetuese. Në fund janë shpërndarë Certifikata të punës vullnetare për secilin vullnetar aktiv gjatë këtij viti, gjithashtu janë shkëmbyer 🎁 dhurata dhe urime për suksese të punës vullnetare në ardhmen.

*** 🎄 Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e ri 2024 🎄 ***





1 BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

2.1 PARTNERSHIP –CHRISTEN FUR EVROPA-DRESDEN GERMANY

Më 24 maj, Deguam 5 të rinjë nga Klina ne Steyberg te Gjermanise, gjithashtu ishin edhe 15 te rinje nga 5 vende të ndryshme evropiane iu bashkuan PaLS projektit për të bërë një shërbim vullnetar në të ashtuquajturat "Ekipet e Korpusit të Solidaritetit Evropian" në periudhë dy javore. Detyra e tyre: të ndërtojnë një shteg natyror Permakulturor dhe të njihen me njëri-tjetrin.

Steyerburg, 24 Maj to 8 Qershor2023

2.3 PARTNERSHIP – HUMAN

Në projektin “Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet OSHC-ve dhe Institucioneve publike në promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë” QRAK eshte partnere lokale dhe ka përgjegjësi për mobilizimin e vullnetarëve dhe vizitën e familjeve derë më derë, bisedën me familjarët dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve, duke rritur në këtë mënyrë ndërgjegjësimin e qytetarëve në zonat rurale për antikorrupsionin, sundimin e ligjit, etikën në qeveri dhe publik. arsimimi.

Zhvilluar prej janar 2023- Dhjetor 2023

2.4 BASHKEPUNIM – KORPUSI I PAQES.

Organizata amerikane Korpusi i paqes ka sjellur tek ne një vullnetar (Zach Bernkoph), për të punuar si vullnetar i korpusit të paqes në Klinë në periudhë prej 24 muajve. Aktiviteti ka filluar në Nëntor 2022 . Vullnetari vazhdoi te punoj në menaxhmentin e Qendres Rinore dhe ka mbeshtetur ekipin punues të projekteve deri në fund Tetorit 2024.

Zhvilluar nga Nëntor 2022-Tetor 2024.



2 PROJEKTET

3.1 PROJEKTI-

Projekti është implementuar nga Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë me përkrahjen e projekt i financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ne Kosovë. Projekti mundësoi realizimin e aktiviteteve dhe funksionimin e qendres rinore ne periudhen 6 mujore duke filluar nga

Nentori 2023

3.2 PROJEKTI- NISMA PËR FUQIZIMIN E TË RINJEVE

Projekti është implementuar nga Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë me përkrahjen e projekt i financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ne Kosovë. Projekti mundësoi realizimin e aktiviteteve dhe funksionimin e qendres rinore ne periudhen 6 mujore duke filluar nga

Nentori 2023

3 STATISTIKAT /PËRFITUESIT